Botimi Nr. 4 / 2 Maj 2020

NewsLetter

20 Years

WWW.AMCHAM.COM.AL

THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

VIDEO TAKIMI

AMBASADORJA E SHBA, YURI KIM

Diskuton me Dhomën Amerikane Sfidat e Bizneseve nga COVID-19

Bordi drejtues i Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe drejtues të bizneseve anëtare zhvilluan më 29 prill një video takim me Ambasadoren e SHBA, Yuri Kim, ku u diskutua gjerësisht mbi sfidat e Covid 19. Ambasadorja e SHBA, Yuri Kim theksoi rolin e rëndësishëm...

» Vijon në faqen 2

PANDEMIA

SQARIME TË MËTEJSHME NË LIDHJE ME RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE SHËRBIMEVE GJYQËSORE!

DELOITTE ALBANIA

Nëpërmjet një njoftimi për shtyp të datës 24.04.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka sqaruar vendimmarrjen e tij të datës 22.04.2020 për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore...

» Vijon në faqen 3

PRESIDENTI I DHOMËS AMERIKANE, ENIO JAÇO:

RUAJTJA E 98% TE PUNONJËSVE NGA ANËTARËT TANË LAJM POZITIV, POR NUK MUND TE ZGJASË EDHE SHUMË.

» Në faqen 2

PANDEMIA

SHTYRJA E AFATIT TË PAGESËS SË KËSTEVE TË TATIMIT MBI FITIMIN DHE DORËZIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

DELOITTE ALBANIA

Në vijim të masave të marra nga qeveria e Republikës së Shqipërisë për lehtësimin dhe përballimin e pasojave të rezultuara nga pandemia Covid-19, në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 24.04.2020 janë ...

» Vijon në faqen 3

COVID 19- ECONOMIC NEWS

Borxhi publik rritet që nga muaji Mars - Qeveria raporton 66.7% të PBB-së, pa korrigjuar rritjen ekonomike – Scan-tv.com

"Leja e qarkullimit për nevojat e subjekteve" në e-albania, bizneset duhet të aplikojnë ndërmjet 3 alternativave

Deklarimi i të ardhurave personale mbi 2 milion lekë shtyhet për në 31 korrik – Monitor.al

Denaj: Financimi i borxhit është i sigurt, edhe nëse Eurobondi nuk lëshohet, ja sa rritet deficiti – Monitor.al

» Në faqen 5

Ambasadorja e SHBA, Yuri Kim Diskuton me Dhomën Amerikane Sfidat e Bizneseve nga COVID-19

» vijon nga faqja 1

...që Dhoma Amerikane e Tregtisë ka luajtur në identifikimin e problemeve dhe rekomandimet e bëra ndaj qeverisë, me zgjidhjet që ofrojnë impakt lehtësues për bizneset. Gjithashtu, Ambasaroja vlerësoi donacionet dhe angazhimin e kompanive anëtare të AmCham për t'i ardhur në ndihmë komunitetit shqiptar në këto kohë të vështira.

Gjatë takimit, Ambasadorja Kim dhe përfaqësuesit e Dhomës Amerikane shkëmbyen mendime të drejpërdrejta mbi sfidat që bizneseve ju është dashur të kapërcejne dhe ato me te cilat po përballen. Takimi ka shërbyer gjithashtu si një platformë per te diskutuar edhe mundësitë e përshtatshme për rihapjen e ekonomisë pa cenuar prioritetin e sigurisë shëndetësore.

Bordi i AmCham dhe drejtuesit e kompanive anëtare shprehën shqetësimin mbi situatën aktuale ekonomike dhe theksuan se nga ana e qeverisë duhet të ndërmerren masa të tjera lehtësuese për të frenuar efektet e padëshirueshme tek bizneset dhe industritë përkatëse. Forcimi i bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe përcaktimi i korridoreve me zona të sigurta ishin gjithashtu pjesë e diskutimeve.

Rritja e shkëmbimeve tregtare midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë është një nga prioritetet kryesore të ambasadores Kim dhe Dhomës Amerikane. Mbështetja e ambasadës për komunitetin e biznesit, do te ndihmojë AmCham dhe anëtarët e saj të mbështesin zbatimin e hapave të mëtejshëm të rëndësishëm që duhet të ndërmerren për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

PRESIDENTI I DHOMËS AMERIKANE NË SHQIPËRI, ENIO JAÇO:

RUAJTJA E 98% TË PUNONJËSVE NGA ANËTARËT TANË LAJM POZITIV, POR NUK MUND TE ZGJASË EDHE SHUMË.

Kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri, Enio Jaço i pyetur lidhur me anketimin e zhvilluar me 78% të anëtarëve të AmCham mbi ndikimin e Covid-19 në fuqinë punëtore, foli për rezultate pozitive dhe rezistencë të antarësisë ndaj impaktit negativ që masat shtrenguese kanë sjellë.

"Numri i vendeve të punës të humbura gjatë kësaj periudhe në kompanitë anëtare të AmCham ka qënë shumë i ulët. Vetëm 466 punonjës, ose 1.9% e totalit të të punësuarve kanë humbur vendin e tyre të punës nga kjo situatë. Kjo shifër është ndjeshëm më e ulët se ajo që ne prisnim dhe ky është një lajm pozitiv. Anëtarët tanë i japin një rëndësi dhe vlerë të madhe forcës së tyre punonjëse dhe e çmojnë si kapitalin e tyre më të rëndësishëm dhe kjo na ka bërë ne të ndihemi më mirë gjatë kësaj periudhe."

Nga ana tjetër kreu i AmCham, Jaço theksoi shqetësimin që vetë anëtarët shprehën në anketën e zhvilluar, se ka një shifër të dytë, të vendeve të punës të cilat mund të shkurtohen në muajt në vijim.

"Ky numër fatkeqsisht është më i lartë se ai i punonjësve të larguar deri më tani. Janë edhe 666 njerëz të tjerë të cilët mund të largohen nga puna në dy muajt e ardhshëm, gjë që në total do të shënonte dicka më pak se 5% e të punësuarve të anëtarëve të AmCham. Kjo na bën të ndihemi të shqetësuar dhe ta monitorojmë vazhdimësinë e këtij procesi në të ardhmen."

Pavarësisht vështirësive të hasura gjatë këtyre dy muajve, asnjë nga anëtarët e Dhomës Amerikane nuk ka shpallur falimentin dhe asnjë nuk po planifikon një gjë të tillë. Por, sipas kreut të AmCham, nuk përjashtohet fakti që një gjë e tillë mund të ndodhë në të ardhmen. Për zbutjen e këtij impakti negativ dhe krijimin e mundësive për vazhdimësinë e bizneseve, Dhoma Amerikane e Tregtisë i ka bërë disa propozime qeverisë.

"Këto kërkesa kishin në thelb aksesin në kapital për kompanitë e përmasave të ndryshme në mënyrë që ato të kenë likuiditet gjatë kësaj periudhe, shtyrjen e pagesës së taksave për 2020 por edhe shtrirjen e të gjitha pagesave të papunësisë për punonjësit e çdo kompanie. Të tre këto propozime u adresuan në paketën e dytë të qeverisë, sigurisht që duke qenë propozime komplekse nuk janë adresuar 100% por kjo është normale."

Për Dhomën Amerikane të Tregtisë përmasa e paketës në ndihmë të bizneseve duhet të rritet, gjë e cila pritet të ndodhë në fazat e mëvonëshme që qeveria do ndërmarrë lidhur me adresimin e krizës ekonomike të shkaktuar nga Covid-19.

SQARIME TË MËTEJSHME NË LIDHJE ME RIFILLIMIN E VEPRIMTARISË DHE

SHËRBIMEVE GJYQËSORE!

PËRGATITUR NGA DELOITTE ALBANIA

» vijon nga faqja 1

...më datë 27.04.2020. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka theksuar se Vendimi nr. 143, datë 22.04.2020 "Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore" ("Vendimi nr. 143") do të zbatohet në përputhje me dhe sipas Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 25.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 16.04.2020.

NË KËTË KUPTIM, KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR SQARON MË TEJ SE:

Veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore do të kufizohen vetëm në ato çështje me natyrë të ngutshme, ndërsa ato me natyrë jo të ngutshme do të vijojnë të jenë të pezulluara;Afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale të një natyre jo të ngutshme vazhdojnë të pezulluara. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk sqaron në këtë njoftim për shtyp kuptimin e kategorisë së"çështjeve me natyrë të ngutshme" apo "çështje me natyrë jo të ngutshme". Sjellim në vëmendje se, në Vendimet e mëparshme të pezullimit, konkretisht Vendimi nr. 127, datë 10.03.2020, Vendimi nr. 128, datë 24.03.2020 dhe Vendimi nr. 133, datë 06.04.2020, Këshilli i Lartë gjyqësor përjashtonte nga efektet e pezullimet veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme. Kësisoj mbetet për t'u sqaruar në vijim gama e çështjeve që rifillojnë sipas Vendimit nr. 143.Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor njofton se është ngritur një komision i posaçëm për hartimin e një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore.Këshilli i Lartë Gjyqësor do të njoftojë në ditët në vijim zhvillimet e reja dhe sqarimet përkatëse.

SHTYRJA E AFATIT TË PAGESËS SË KËSTEVE TË TATIMIT MBI FITIMIN DHE DORËZIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

» vijon nga faqja 1

...publikuar Aktet Normative nr.18, datë 23.04.2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe nr. 19, datë 23.04.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar sipas të cilëve parashikohen afate të reja për parapagimin e këstëve të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin e thjeshtuar sipas kategorive të caktuara të tatimpaguesve, shtyrjen e afatit të dorëzimit të deklaratës individuale të të ardhurave, si dhe përjashtime të reja nga taksa e ndikimi në infrastrukturë.

» Afate të reja dhe përjashtime të parapagimeve të këstëve të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin e thjeshtuar

Në tabelën e mësipërme paraqiten në mënyrë skematike, afatet e reja të parapagimit të këstëve të tatimit mbi fitimin, si dhe kategoritë e tatimpaguesve të cilëve iu zbatohen.

Ndër të tjera, sipas akteve normative të mësipërme parashikohen gjithashtu:

» Shtyrja e afatit te dorëzimit të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave dhe pagesës së detyrimit *(nëse rezulton me detyrim)* më 31 korrik 2020 (afati ligjor i zakonshëm ishte 30 prill 2020);

» Përjashtohen nga pagesa e taksës mbi ndikimin në infrastrukturë investimet në kuadër të programeve të rindërtimit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Parashikimet e mësipërme ligjore hyjnë në fuqi menjëherë duke filluar nga 25.04.2020.

DETYRIMI LIGJOR	KATEGORIA E TATIMPAGUESVE	Afati ligjor përjashtimor sipas Paketës Financiare nr. 1	Afati ligjor përjashtimor sipas Paketës Financiare nr. 2
Prepayment of corporate income tax installments for year 2020	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor > 14 milionë Lekë, përvec veprimtarive të mëposhtme: - bankë; - telekomunikacion; - tregtimi i produkteve farmaceutike; - tregtimi i produkteve ushqimore dhe fruta – perimeve	30 mars, 30 qershor, 30 shtator, 30 dhjetor 2020 (nuk kishte shtyrje të afateve)	Këstet e 30 qershorit dhe të 30 shtatorit të vitit 2020 do të shtyhen për periudhën prill - shtator 2021. Nuk ka shtyrje për këstin e 30 dhjetorit.
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor < 14 milionë Lekë	Kurdo brenda 31 dhjetorit 2020	Nuk do të paguhen
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin e thjeshtuar me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë Lekë	20 prill, 20 korrik, 20 tetor, 20 dhjetor (nuk kishte shtyrje të afateve)	Nuk do të paguhen
	Tatimpaguesit në fushën e turizmit dhe të përpunimit aktiv me material porositësi, si dhe call center	Në varësi të përgjegjësisë tatimore dhe qarkullimit	Këstet e tatimit mbi fitimin për periudhën prill-dhjetor 2020 do të shtyhen për periudhën prill - dhjetor 2021.

AMERICAN BANK OF INVESTMENTS

Investo në Optimizëm!

ABI Bank i ka dhuruar tre pajisje respiratore për terapi intensive sistemit shëndetësor

"Pajisje respiratore që dhurojmë sot, do të lehtësojnë punën e këtyre heronjve dhe heroinave dhe do ndihmojnë në misionin fisnik të shpëtimit të jetëve të gjithë popullit shqiptar"

DHOMA AMERIKANE ËSHTË KRENARE PËR ANËTARËT E SAJ!

ABI Bank i ka dhuruar tre pajisje respiratore për terapi intensive sistemit shëndetësor, duke shprehur në këtë mënyrë mirënjohjen e thellë ndaj sakrificës së mjekëve dhe infermierëve në këto kohë lufte të COVID-19. Zëvendësministrja e Shëndetësisë Mira Rakacolli, vlerësoi përgjegjësinë sociale që ABI Bank ka treguar në ndihmë të sistemit shëndetësor, një kontribut që do t'i vlejë gjatë sistemit shëndetësor publik edhe pas përfundimit të pandemisë COVID-19. "Moto e ABI Bank ka qenë dhe është Investo në Optimizëm! Ndihemi të privilegjuar që na jepet mundësia të falënderojmë gjithë komunitetin e mjekëve dhe infermierëve. Këto pajisje respiratore që dhurojmë sot, do të lehtësojnë punën e këtyre heronjve dhe heroinave dhe do ndihmojnë në misionin fisnik të shpëtimit të jetëve të gjithë popullit shqiptar" – thotë Drejtorja e Divizionit Ligjor dhe Përputhshmërisë në ABI Bank, znj. Vilsa Lika.

World Vision

Mbështetje psikologjike për fëmijët

Projekte ndihme për 62 familje fermerësh

World Vision Albania ka mbështetur familje në Shqipëri dhe Kosovë me paketa ushqimore

DHOMA AMERIKANE ËSHTË KRENARE PËR ANËTARËT E SAJ!

Në situatën e jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, World Vision Albania ka mbështetur 2,148 familje ose mbi 8,905 të rritur dhe fëmijë në Shqipëri dhe 150 familje Kosovë me paketa ushqimore dhe higjienike. Gjithashtu, falë projektit #RE-IN-VEST, edhe 104 familje të rikthyera nga emigracioni janë mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike. Fëmijët kanë qenë gjithashtu në qendër të vëmendjes së World Vision, të cilët nëpërmjet një cikli inovativ dhe dy profesionistëve në fushën e psikologjisë, do të shpjegojnë dhe këshillojnë për aspekte të shëndetit mendor të fëmijëve dhe të familiarëve gjatë situatave të emergjencës. Pjesë e projekteve të ndihmës kanë qenë edhe 62 familje fermerësh në disa fshatra të zonës së Librazhdit dhe Përrenjasit, të cilët janë mbështetur me 4,600 fidanë lajthie për të zhvilluar aktivitetin e tyre bujqësor gjatë kësaj kohe.

iutecredit

IuteCredit Albania ka ndërmarrë tre nisma të ndryshme

Pajisje mjekësore për Repartin e Reanimacionit të Spitalit Infektiv

Pako me ushqime per 100 familjeve më në nevojë, në qytetet e Elbasanit dhe Durrësit Mbështetur në nismën "Adopto një Gjysh/Gjyshe" duke adoptuar jo një, por 50 gjyshe/gjyshër

DHOMA AMERIKANE ËSHTË KRENARE PËR ANËTARËT E SAJ!

Në këtë situatë pandemie botërore të krijuar nga COVID-19, IuteCredit Albania nuk mund të qëndronte indiferente. Çdo vit, IuteCredit një pjesë të fitimit vjetor e përdor për t'i ardhur në ndihmë shtresave më në nevojë të shoqërisë dhe pikërisht këtë ka bërë edhe gjatë situatës së pandemisë. Institucioni financiar ka ndërmarrë tre nisma të ndryshme. Së pari, IuteCredit Albania i dhuroi Qendrës Spitalore "Nënë Tereza" pajisje mjekësore për Repartin e Reanimacionit të Spitalit Infektiv, ku po trajtohen të prekurit nga COVID-19. Këto pajisje do të lehtësojnë punën e mjekëve për ndjekjen e parametrave jetësorë të të shtruarve në këtë repart. Së dyti, IuteCredit iu bashkua fondacionit "Fundjavë Ndryshe" për t'i ardhur në ndihmë 100 familjeve më në nevojë, në qytetet e Elbasanit dhe Durrësit, duke dhuruar pako me ushqime të mjaftueshme për një muaj. Së treti, kanë mbështetur nismën e Bashkisë së Tiranës "Adopto një Gjysh/Gjyshe" duke adoptuar si institucion jo një, por 50 gjyshe/gjyshër të Njësisë Administartive numër 9, duke i ndihmuar dhe duke i qëndruar pranë në këto ditë të vështira. "Ne ndiejmë që kemi një detyrim moral për të ndihmuar në momente të vështira ata që kanë më shumë nevojë. Shpresojmë që i gjithë komuniteti i biznesit do të dijë të japë shembullin e mirë, duke u solidarizuar me shtresat më në nevojë, për ta kaluar të gjithë bashkë këtë krizë shëndetësore dhe ekonomike"- thotë IuteCredit Albania.

COVID-19

BORXHI PUBLIK RRITET QË NGA MUAJI MARS - QEVERIA RAPORTON 66.7% TË PBB-SË, PA KORRIGJUAR RRITJEN EKONOMIKE – *Scan-tv.com*

Borxhi publik iu kthye rritjes qysh në tremujorin e parë të vitit. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, për tre muajt e parë të vitit 2020 stoku i borxhit publik u rrit me 50 miliardë lekë dhe arriti një vlerë totale prej 1 trilionë e 162 miliardë lekësh ose rreth 9.3 miliardë eurosh. Statistikat zyrtare e kanë reflektuar rritjen edhe në treguesit realë, megjithëse kjo rritje paraqitet larg asaj që pritet të jetë përmasa reale.

"LEJA E QARKULLIMIT PËR NEVOJAT E SUBJEKTEVE" NË E-ALBANIA, BIZNESET DUHET TË APLIKOJNË NDËRMJET 3 ALTERNATIVAVE

Të gjithë bizneset që janë rihapur normalisht duhet të pajisin me leje dalje të gjithë punonjësit e tyre dhe përdorimin e automjeteve në funksion të aktivitetit. Në e-albania është shtuar opsioni "Leje qarkullimi për nevojat e subjekteve", nëpërmjet së cilës bizneset mund të zgjedhin midis 3 alternativave sipas nevojave të tyre.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE PERSONALE MBI 2 MILION LEKË SHTYHET PËR NË 31 KORRIK – *Monitor.al*

Fundi i prillit është afati i fundit zyrtar për të gjithë individët, të cilët bëjnë deklarimin online të të ardhurave të tyre personale, kur ato i kalojnë 2 milionë lekë (DIVA-Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave). Por, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, Ministria e Financave e ka shtyrë këtë afat për deklarimet e vitit 2019.

DENAJ: FINANCIMI I BORXHIT ËSHTË I SIGURT, EDHE NËSE EUROBONDI NUK LËSHOHET, JA SA RRITET DEFICITI – *Monitor.al*

Në Aktin e Parë Normativ të Buxhetit, deficiti u zgjerua në 3.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e fundit, parashikon një deficit më të zgjeruar prej 5.4% dhe ne nuk e përjashtojmë mundësinë për këtë skenar, tha Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, në një intervistë për Monitor.

ÇUÇI: 70% E FONDEVE TË SKEMËS KOMBËTARE DO TË SHKOJNË PËR BLEGTORINË, APLIKIMET FILLOJNË BRENDA NJË MUAJI – *Monitor.al*

Fermerët do të nisin aplikimet brenda një muaji për të përfituar nga fondet që jep buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin bujqësor përmes Skemës Kombëtare. Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bledi Çuçi, tha se këtë vit pjesa më e madhe e fondeve do të shkojë për të mbështetur blegtorinë. Subvencionet do të jepen për tufën bazë, për krerët e lopëve dhe të të imtave të matrikulluara.

TRI SFIDAT EKONOMIKE TË SHQIPËRISË - KE: KLIMA E BIZNESIT, KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE, DIVERSIFIKIMI I ENERGJISË – *Scan-tv.com*

Komisioni Europian në dokumentin e punës për vlerësimin e reformave ekonomike në vendin tonë, nënvizon edhe tre sfida kyçe për Shqipërinë. Siç e thekson qysh në krye të herës dokumenti, kriza e shkaktuar nga Covid-19 nuk i ndryshon aspak prioritetet e vendit tonë në drejtim të programit ekonomik, por thjesht i bën ato më emergjente. Sfida numër një i referohet përmirësimit të aftësive të popullsisë për të përmbushur edhe nevojat e tregut të punës.

KRIZA E KORONAVIRUSIT, SI PO REAGOJNË PUNËDHËNËSIT MË TË MËDHENJ – *Monitor.al*

Kompanitë më të mëdha në vend të prodhimit, eksportit dhe tregtimit, pohojnë se për shkak të krizës nga koronavirusi ndikimet, po ndihen edhe te punësimi dhe te pagesat e punonjësve. Kompania Balfin pohon se nuk ka asnjë shkurtim të vendeve të punës, por për më pak se 30% të punonjësve ka pasur një rishikim të përkohshëm të pagesave. Kompanitë call center, ndër punëdhënësit më të mëdhenj në vend, vazhdojnë me 20% të fuqisë punëtore në zyra, pjesa tjetër punojnë nga shtëpia. Prodhuesit e këpucëve dhe përpunuesit e peshkut po shohin mundësinë e nxjerrjes së punonjësve në asistencë, nëse nuk do t'u mundësohet ndihmë nga shteti me paketën e zgjeruar.

KRIZA PREK EKSPORTUESIT KRYESORË, SI DO TË NDIKOJË DERI NË VITIN 2021 – *Monitor.al*

Eksportuesit më të mëdhenj në vend parashikojnë se ekonomia nuk do të mund të ringrihet në 8 muajt e mbetur të vitit, për shkak të krizës nga pandemia globale. Kompania "Kurum" aktualisht po eksporton 30% të prodhimit krahasuar me kohë normale. Situata paraqitet e vështirë edhe për sektorin e çimentos, ku prodhimi dhe tregtimi është 50% më pak krahasuar me muajt mars-prill 2019. Edhe prodhuesin e këpucëve "Albaco Shoes", rënia e eksporteve është e lartë. Eksportuesi më i madh i peshkut "Coral" pohon se aktualisht nuk ka asnjë porosi të re përpunimi.

SONDAZHI: BIZNESET E PRODHIMIT MUNGESE LIKUIDITETI, 83% NUK MUND TË PAGUAJNË DETYRIME; 65% TË PAKENAQUR ME PAKETËN E SHPËTIMIT TË QEVERISË – *Monitor.al*

83% e bizneseve prodhuese pohuan se nuk kanë likuiditet të mjaftueshëm për të paguar detyrimet, si rrjedhojë e rënies së ndjeshme të të ardhurave, sipas një Sondazhi që Bashkimi i Prodhuesve realizoi me 100 anëtarë të e tij. Po rreth 80% e bizneseve pohojnë se ata mund të paguajnë pagat për punonjësit e tyre edhe për maksimumi dy muaj.

FMN: PAKETAT E NDIHMËS PËR SHTRESAT NE NEVOJE KANË NEVOJË PËR TRANSPARENCË; NE JEMI GATI PËR NJË MARRËVESHJE ME SHQIPËRINË – *Monitor.al*

Shefja e re e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, Yan Sun dhe shefi në ikje, Jan Kees Martijn, në një intervistë të përbashkët për Monitor thanë se deficiti buxhetor i Shqipërisë shkon këtë vit përtej nivelit 5% të PBB-së, nëse kriza zgjidhet në 6-mujorin e dytë. FMN sugjeron që paketat mbështetëse të qeverisë për familjet dhe biznesin të shkojnë tek më të prekurit dhe të shoqërohen me transparencë. Fondi këshillon Shqipërinë që të diversifikojë prodhimin edhe eksportit, duke iu larguar varësisë nga Italia. Sun shpreh gatishmërinë e FMN për marrëveshje me Shqipërinë.

OECD VLERËSON NDIKIMIN E COVID-19 NË EJL, VEÇANËRISHT TË RËNDË PËR SHQIPËRINË PËR KËTO ARSYE – *Monitor.al*

Një raporti i Organizatës Për Bashkëpunim dhe Zhvillim (OECD) ka shqyrtuar ndikimet dhe pasojat e pandemisë koronavirus në jetën dhe shoqërinë e vendeve të Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë. Studimi shikon se si përhapet virusi në rajon, si po merren masat frenuese dhe si po përballen sistemet e kujdesit shëndetësor dhe ekonomitë.

SHQIPËRIA DO TË BASHKOHET MBI 100 SHTETE NË TË CILËT STUDIOJNË PËR TË GJETUR TRAJTIMIN E COVID-19 - *Exit.al*

Organizata Botërore e Shëndetit do të zhvillojë një studim për të gjetur trajtime efektive për COVID-19 në mbi 100 vende, përfshirë Shqipërinë. Testet do të bëhen me pëlqimin e pacientëve të rritur që janë diagnostikuar me COVID-19 dhe janë shtruar në spital. Këta pacientë do të marrin ilaçe që janë duke u studiuar për ndikimin e tyre në virus dhe kushtet e tjera që mund të shkaktojë.